

VENDIMI I ASAMBLESES SE PËRGJITHSHME
"DEVOLLI LOGISTIC SYSTEM" SH.P.K
PËR PJESMARRJEN SI ORTAK NË NJË SHOQËRI NË SHQIPËRI

Bordi i "DEVOLLI LOGISTIC SYSTEM" SH.P.K, me numër të regjistrimit të biznesi 810867707 , me seli ne Rruga "Zona Industriale", Fabrika e Amortizatorëve, Prishtinë, Kosovë, në mbledhjen e saj të mbajtur më date **04/04/2025** pas diskutimeve dhe shqyrtimeve, aprovoi këtë:

Asambleja e Përgjithshme e kompanisë "Devolli Logistic System" Shpk, mbledhur në datën 04/04/2025, pas shqyrtimit të kërkesave dhe nevojave për zgjerimin e veprimtarisë së kompanisë pasi shqyrtoi rendin e ditës , merr vendimin e mëposhtëm:

Themelim Kompanie në Shqipëri me emër "Devolli Logistic Center Albania" sh.p.k

Asambleja e Përgjithshme miraton pjesmarrjen e shoqërisë " Devolli Logistic System " Shpk me NUI 810867707 në masën 100 % aksionere e vetme në Republikën e Shqipërisë tek shoqëria që do krijohet me emrin "Devolli Logistic Center Albania" sh.p.k me seli në objektin "Prestige Industrial Park", pasuria Nr. 174/2, ZK 3974 , Vorë Tiranë, Shqipëri, e cila do të ushtrojë aktivitetin e saj sipas legjislacionit Shqipëtar.

Kapitali

Kapitali i themelimit të kompanisë së re do të jetë **50,000 (pesedhjetë mijë) lekë**, i cili do të kontribuohet nga " Devolli Logistic System" Shpk.

Emërimi i Administratorit dhe Personave Përgjegjës

Asambleja autorizon në cilësinë e adiministratorit të shoqërisë **Z. Drilon TAHIRI, me nr.ID 2003664387** për të emëruar drejtorët dhe personat përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e kompanisë "Devolli Logistic Center Albania" sh.p.k në Shqipëri, duke përfshirë autorizimin për nënshkrimin e kontratave dhe dokumenteve të nevojshme për regjistrimin dhe themelimin e saj në përputhje me ligjet dhe rregullat shqiptare.

Regjistrimi i Kompanisë

Administratori Z.Drilon Tahiri autorizohet për të realizuar të gjitha veprimet dhe procedurat ligjore të nevojshme për regjistrimin e kompanisë së re në regjistrin e kompanive në Shqipëri dhe për të siguruar përmbushjen e kërkesave ligjore për themelimin dhe operimin e saj, duke pasur dhe të drejtën për të autorizuar persona të tretë me tagrin për të kryer këto procedura pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Shqipëri.

Afatet dhe Detajet e Tjera

Asambleja miraton që menaxhimi të sigurojë përmbushjen e afateve të regjistrimit dhe hapjes së aktivitetit të kompanisë, duke përcaktuar gjithashtu detajet e tjera për hapjen e zyrave, punësimin e stafit dhe realizimin e planit të biznesit.

VENDIMI MARRË DHE MIRATUAR

Ky vendim është miratuar unanimsisht nga të gjithë anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të "Devolli Logistic Center Albania" Shpk në mbledhjen e datës 04.04.2025.



Për çdo çështje tjetër që lidhet me themelimin dhe zhvillimin e kompanisë, Asambleja autorizon menaxhimin dhe organet përkatëse të veprojnë sipas nevojave.

Shkëlqim Devolli

(nënshkrimi)

